Ne autorizojme autoritetin kontraktor të verifikojë informacionin e dhënë në këtë tabelë.

PERSONI I KONTAKTIT (për këtë ofertë)

Emri:

Adresa:

Nr. Telefonit:

Faks:

E-mail:

Nenshkrimi

Shtojca 10

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik)

DEKLARATË MBI KONTRATAT E LIDHURA DHE/ OSE NE PROCËS²

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj se kam në proces dhe/ose jam shpallur fitues për kontratat e mëposhtme:

Nr.	Autoriteti kontraktor	Objekti i procedurës se prokurimi/kontratës	Vlera e shpallur fituese

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shënim: Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

² Kjo deklarate ka si qëllim plotësimin e kriterit ligjor që operatorit ekonomik brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nëkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura dhe/ose është shpallur fitues, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent

Shtojca 11

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 4.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar, sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

b. Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur sipas Shtojcës 1/1;

c. Deklaratën mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 4/1;

ç Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;

d. Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;

dh. Formular vlerësimi sipas Shtojcës 8;

e. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 9 ;

f. Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo në proces sipas Shtojcës 10;

g. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Për kapacitetin ligjor/profesional:

2.1.1 Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, **kjo jo vetëm për selinë që jeni regjistruar por dhe për niptin sekondar nëse keni sipas ekstraktit historik të subjektit për vitin 2019, leshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.**

Vërtetimi të jetë leshuar nga Autoriteti Vendore brenda 3 muajve nga data e hapjes së tenderit.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimet si me sipër leshuar nga Qeverisjes Vendore në të cilën është regjistruar sipas QKB).

2.1.2 Plotesimi i të gjithë shtojcave sipas DST.

2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Xhiroja mesatare e realizuar nga Operatori Ekonomik gjatë tre viteve **2017, 2018, 2019**, duhet të mos jete me e vogel se **vlera e fondit limit** dhe sipas natyres se objektit te kontrates.

Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje vërtetim nga Drejtoria e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e fundit.

2.2.2 Operatori Ekonomik duhet të kete nje aktivitet pozitiv te qendrueshem (Te mos kete bilanc negativ te dy viteve te njepasnjeshem) gjate tre viteve te fundit 2017, 2018, 2019.

Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese kopje të bilanceve të tre viteve të fundit, të paraqitur pranë autoritetit përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet.

2.3 Për kapacitetin teknik:

2.3.1.Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

- a. Punë të ngjashme për një kontratë të vetme të së njëjtës natyrë në një vlerë minimalisht prej 50% e fondit limit **ne leke pa T.V.SH** të ekzekutuar gjatë tre viteve të fundit referuar dates se hapjes se ofertave;

DHE/OSE

- b. Punë të ngjashme ku vlera totale e punës së tre viteve të fundit referuar dates se hapjes se ofertave, është të paktën një vlerë **sa dyfishi i vleres se fondit limit pa T.V.SH**.

Punë e ngjashme do të merret në konsiderat nëse zërat e punimeve janë të ngjashëm me zërat e punimeve të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e suksesshme në ekzekutimin e një kontrate të ngjashme të së njëjtes natyrë, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtem:

- Kontratën/Kontratrat me entet publike për përmbushjen me sukses të punëve ku të shënohen vlera, koha, natyra e punës, shoqëruar me vërtetim nga investitori, për vlerën e kontratës, cilesinë e punimeve, afatin kohor të realizimit të punimeve.
- Situacione përfundimtar të objektit,
- Faturat tatimore per çdo situacion
- Aktin e Kolaudimi përfundimtar të objektit,
- **Formular vlerësimi.**

Ne rastet e pervojës se meparshme te realizuar ne sektorin privat operatori ekonomik duhet te paraqese:

- Kontrate
- Lejen e ndertimit
- Situacion përfundimtar të objektit,
- Faturat tatimore te deklarimit te objektit ne organet tatimore.

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomike pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Pika 1/b duhet te plotësohet nga te gjithë anetaret e bashkimit ne raport me perqindjen e pjesmarrjes se tyre ne bashkim.

2.3.2 Operatoret ekonomike duhet te disponojne licensen me kategorite e nevojshme per zbatimin e kontrates. Per kete duhet te paraqesin licensen perkatese te shoqerise, bazuar ne formatin e miratuar me Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008; *Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit,*

klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi”. Shqyrtimi i licencave do te behet mbi bazen e rregullave te parashikuara ne sa mesiper. Licensa profesionale e operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e puneve te kontrates duhet te permbaje kategorie e me poshtme sipas modelit te leshuar nga MTI.

Liçenca profesionale, lidhur me ekzekutimin

Per punimet e pergjithshme te ndertimit kompania duhet te kete licensat e meposhtme:

- NP – 1 A (Punime germimi ne toke)
- N.P – 5 A (Punime nëntokësore, ura e vepra arti).
- N.P - 9 A (Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime).
- N.P – 12 A (Punime të inxhinierisë së mjedisit).

Per punimet speciale te ndertimit kompania duhet te kete licensat e meposhtme:

- N.S – 18 A (Punime topogjeodezike).

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

2.3.3 Kandidatet ofertues duhet të përcaktoje me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin/(t) Teknik të punimeve në objekt dhe të deklaroje se ai/ata do të jetë/jenë i/ të pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqeruar me dokumentacionin e meposhtem:

- Kontrate pune e vlefshme.
- Diplome.

2.3.4. Operatori/operatoret ekonomike pjesemarres duhet te kete/kene një punësim mesatar *me kohe te plote* ne çdo muaj i të paktën 35 (**Tridhjetë e pesë**) personave per periudhen **Janar – Korrik 2020** të vërtetuar me;

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; **per periudhen e mesiperme.**
- b. Listë-pagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi **per periudhen e mesiperme**, te konfirmuar nga Administrata Tatimore, shoqeruar me formularet e deklarimit te kontributeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore, formularet e deklarimit te te ardhurave nga punesimi.

2.3.5. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar dhe të ketë në stafin e tij dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë, për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë, stafin inxhinierik si më poshtë:

- **Inxhinier Ndertimi (1)**
- **Inxhinier Mjedisi (1), i pajisur me Certificate të Vleresimit të Ndikimit në Mjedis.**

2.3.6. Gjithashtu operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar me Kontrata Pune dhe certifikatat respektive, dhe të figurojnë në listepagesa për të paktën 3 (Tre) muajt e fundit, stafin mbështetës si më poshtë:

- (2) Manovratore të pajisur me Leje/Deshmi përkatëse.
- (2) drejtues automjetesh (shofere)/ Deshmi përkatëse.
- 2 (Dy) muratore/ Deshmi/certifikatat përkatëse.
- **1** (një) punonjës të pajisur me certifikatë "*Ekspert për ndihmën e parë dhe nderhyrjen ndaj emergjencave*".
- **1** (një) punonjës të pajisur me certifikatë trajnimi "*Përgjegjës/Specialist për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë*".

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë certifikata cilësie në gjuhën shqipe, ose të përkthyer dhe të noterizuara, si më poshtë:

- **ISO 9001- 2015 (Sistemi i menaxhimit të Cilësisë)** ose ekuivalente me to, leshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim. (*Ne rast të dorëzimit të ofertës nga bashkimi i operatoreve ekonomike, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë persiper të realizojë sipas aktmarreveshjes*).
- **ISO 14001-2015 (Sistemi i menaxhimit Mjedisor)** ose ekuivalente me to, leshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim. (*Ne rast të dorëzimit të ofertës nga bashkimi i operatoreve ekonomike, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë persiper të realizojë sipas aktmarreveshjes*).
- **PAS 99-2012 (Sistemi i Integruar i menaxhimit)** ose ekuivalente me to, leshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim. (*Ne rast të dorëzimit të ofertës nga bashkimi i operatoreve ekonomike, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë persiper të realizojë sipas aktmarreveshjes*).
- **ISO 18001 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë)** ose ekuivalente me to, leshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim. (*Ne rast të dorëzimit të ofertës nga bashkimi i operatoreve ekonomike, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë persiper të realizojë sipas aktmarreveshjes*).

Kandidati ofertues duhet të paraqesë certifikatat e mësipërme: (Ne rasin e bashkimit të operatoreve ekonomike secili nga operatorët duhet të zotërojë certifikatat e mësipërme)

Certifikatat të jenë në gjuhën shqipe ose të përkthyer dhe të noterizuara. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatat ISO).

2.3.8 Ofertuesit duhet të paraqesin kontratë furnizimi shoqëruar me certifikatë cilësie për materialin "**rrjete teli ekzagonal**", që do të përdoret për këtë objekt sipas specifikimeve teknike të përdorura në këtë prokurim.

2.3.9 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund të vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, si më poshtë:

Mjetet	Pronësia	Njesia	Sasia
Kamion vetëshkarkues (me kapacitet mbajtes mbi 18 ton)	Ne pronesi ose me qera	copë	2
Kamioçina	Ne pronesi ose me qera	copë	1
Autovinc	Ne pronesi ose me qera	copë	1
Betoniere	Ne pronesi ose me qera	cope	5
Vibrator	Ne pronesi ose me qera	copë	2
Eskavator	Ne pronesi ose me qera	copë	2
Tokmak	Ne pronesi ose me qera	cope	2
Nyje prodhimi inertesh e pajisur me Leje Mjedisi të Vlefshme	Ne pronesi ose me qera ose kontratë furnizimi		1
Kaska kokore	Ne pronesi ose me qera	cope	26
Jelek pune	Ne pronesi ose me qera	copë	26
Gjenerator	Ne pronesi ose me qera	copë	1

Mjetet e lartpërmendura duhet të jenë në pronësi ose me qera dhe ofertuesi duhet të paraqesë deklarin për disponimin e makinerive të shoqëruar me dokumentat e mëposhtëm:

- a) Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumentat e mësipërme duhet të shoqërohen me kontratën noteriale përkatëse të qerës/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.*
- b) Në rastin e mjeteve apo makinerive të tjera duhet të jenë dokumenti që provon disponimin e mjetit si aktet e çdoganimit dhe ose faturat tatimore të blerjes.*
- c) Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë se mjetet e paraqitura në oferte nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe do të jenë në dispozicion të zbatimit të punimeve në objektin që tenderohet.*

Dokumenta Standarde të Tenderit

- d) Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi ne çdo kohe prej Autoritetit Kontraktor.*
- e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim

Shtojca 12

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrim i punëve: "Ngarkuar si file me vete ne sistem"

Grafiku i Punimeve: 30 ditë

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: "Ngarkuar si file me vete ne sistem"

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë te ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Shtojca 13

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

PREVENTIVAT E PUNIMEVE

Nr	Nr. Analize	PERSHKRIM I PUNIMEVE NË SHKOLLA 9 - VJECARE DARDHAS	NJESIA	SASIA	ÇMIMI	VLERA
1	3.243	Beton C 16/20 per mur	m3	26.82		
2	3.25c	Germim themeli me krah ne seksion te detyruar	m3	49.82		
3	3.353	Mbushje me shkemb te copetuar	m3	140		
4	3.89/b	Germim dheu me eskavator me goma me gjeresi mbi 2m ne toke te zakoneshme kat .III.me shk tok	m3	80		
5	2.88	Mur blloqe/betoni deri h=3m me llac M.15	m3	17.04		
6	3.365	F.V.Tubo betoni ϕ 600 mbi shtrese betoni	ml	28		
7	2.390/1+an	F.V dere metalike(kryesore)	m2	5.4		
8	3.209	F.V pllaka betoni M-300 t= 6cm mbi shtrese rere	m2	399		
9	3.617	F.V.Bordure betoni 15x25cm	ml	25		
		SHUMA NR 1 PA T.V.SH				
Nr	Nr Analiz	PERSHKRIM I PUNIMEVE, KALCETO DARDHAS	NJESIA	SASIA	ÇMIMI	VLERA
1	2.426/4	Prishje shtrese betoni	m3	20		
2	2.426/1	Prishje mur tulle me pastrim	m3	40		
3	3.89/b	Germim dheu me eskavator me goma me gjeresi mbi 2m ne toke te zakoneshme kat .III.me shk tok	m3	144		
4	An -30	Rrethim me rrjete teli ekzogonal 6x8 me diameter 2.2-2.4mm te veshur me (zn 5%Al) me bordature anesore ϕ 3.4/3.0mm	m2	366		
5	2.390/1+an	F.V dere metalike(kryesore)	m2	2.2		
		SHUMA NR.2 PA T.V.SH				
Nr	Nr Analiz	PERSHKRIM I PUNIMEVE NË SHKOLLA 9VJECARE CERRAVE	NJESIA	SASIA	ÇMIMI	VLERA
1	3.209	F.V pllaka betoni M-300 t= 6cm mbi shtrese rere	m2	600		
2	3.617	F.V.Bordure betoni 15x25cm	ml	20		
3	An	F.V.stola ne oborr	cop	10		

Dokumenta Standarde të Tenderit

SHUMA NR.3 PA T.V.SH						
Nr	Nr Analiz	PERSHKRIM I PUNIMEVE SHKOLLA 9 - VJECARE VERDOVE	NJESIA	SASIA	ÇMIMI	VLERA
1	3.209	F.V pllaka betoni M-300 t= 6cm mbi shtrese rere	m2	464		
2	3.617	F.V.Bordure betoni 15x25cm	ml	103		
3	An	F.V.stola ne oborr	cop	10		
SHUMA NR.4 PA T.V.SH						925001
Nr	Nr Analiz	PERSHKRIM I PUNIMEVE NË SHKOLLA 9VJECARE ALARUP	NJESIA	SASIA	ÇMIMI	VLERA
1	3.25c	Germim me krah seksion i detyruar	m3	8.88		
2	3.837/a	Rrethim shkollë me kolla b/a +rrjete teli h=1.5-2m	m2	99.45		
3	2.390/1+an	F.V dere metalike(kryesore)	m2	4.5		
SHUMA NR.5 PA T.V.SH						
Nr	Nr Analiz	PERSHKRIM I PUNIMEVE LESHNICE KALCETO	NJESIA	SASIA	ÇMIMI	VLERA
1	3.89/b	Germim dheu me eskavator me goma me gjeresi mbi 2m ne toke te zakoneshme kat .III.me shk tok	m3	180		
2	An -30	Rrethim me rrjete teli ekzogonall 6x8 me diameter 2.2-2.4mm te veshur me (zn 5%Al) me bordature anesore ϕ 3.4/3.0mm	m2	384		
3	2.390/1+an	F.V dere metalike (kryesore)	m2	2.2		
SHUMA NR.6 PA T.V.SH						
Nr	Nr Analiz	PERSHKRIM I PUNIMEVE NË SHKOLLA 9VJECARE MEMLIHT	NJESIA	SASIA	ÇMIMI	VLERA
1	3.209	F.V pllaka betoni M-300 t= 6cm mbi shtrese rere	m2	680		
2	3.617	F.V.Bordure betoni 15x25cm	ml	30		
SHUMA NR.7 PA TVSH						
Nr	Nr Analiz	PERSHKRIM I PUNIMEVE NË SHKOLLA 9 - VJECARE GESHTENJAS	NJESIA	SASIA	ÇMIMI	VLERA

Dokumenta Standarde të Tenderit

1	3.209	F.V pllaka betoni M-300 t= 6cm mbi shtrese rere	m2	548		
2	3.617	F.V.Bordure betoni 15x25cm	ml	104		
		SHUMA NR.8 PA TVSH				
		SHUMA PA TVSH NGA NUMURI 1- 8 PA TVSH				
		T.V.SH. 20%				
		VLERA TOTALE ME TVSH				

Shtojca 14.

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR³

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimet Publike”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< **Emri** >

³ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore.

Shtojca 15

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Dokumenta Standarde të Tenderit

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 16

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____

Shtojca 17

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS Punët –Kërkesë për propozim

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv për njësi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njësi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikun për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjijtjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

Dokumenta Standarde të Tenderit

- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontratës. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Nëse kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jetë dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punon në objektin e kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikrat e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupuara. Veprimet e korrupuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në kofidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtion ruajtjen e kofidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë

zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, “origjinë” do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 9: Komunikimi

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10: Bashkepunimi në Kantier me të Tjerët

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkepusojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor

11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me përjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit

12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.

12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet

13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.

13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta kishte reklamuar këtë të Autoriteti Kontraktor.

13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve

14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhë atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

Neni 15: Ngritja e Kantierit

15.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.

15.2 Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

Neni 16: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor

16.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.

16.2 Kontraktori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen

dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike të rezyrtshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

Neni 17: Zbulimet

17.1 Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohen për të vepruar konform legjislacionit në fuqi. Kontraktori duhet të njoftojë drejtuesin e projektit për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhëzimet e drejtuesit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve.

Neni 18: Disponimi i Kantierit

18.1 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi të drejtën e disponimit të kantierit kontraktorit në datën e hyrjes të shprehur në dokumentat e tenderit. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës, dhe kontraktori i lind e drejta të kërkojë amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.

Neni 19: Raportimi i Grafikut të Zbatimit

19.1 Menjëherë pas lidhjes së kontratës, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një program plani që tregon metodat e përgjithshme, rregullimet, porosinë, afatet dhe rrugët kritike për aktivitetet e Punimeve .

19.2 Në intervale të skeduar rregullisht siç është aprovuar nga drejtuesi i projektit, kontraktori duhet të përgatisë raportime duke treguar progresin e arritur në çdo aktivitet dhe efektet e progresit në punën e mbetur, duke përfshirë çdo ndryshim në sekuencën e aktiviteteve.

Neni 20: Paralajmërimi në Kohë

20.1 Kontraktori duhet të paralajmërojë drejtuesin e projektit sa më shpejt të jetë e mundur për ngjarje dhe rrethana specifike që mund të ndodhin në të ardhmen apo që mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e kontratës, duke përfshirë cilësinë e punës dhe vonesën në afate.

Neni 21: Kontrolli i Cilësisë

21.1 Kontraktori do të jetë plotësisht përgjegjës për kontrollin e cilësisë dhe zbatimin e kontratës.

21.2 Sapo të lidhë kontratën, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një plan për kontrollin e cilësisë së aktiviteteve në zbatimin e kontratës.

21.3 Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë punën e kontraktorit dhe të njoftojë kontraktorin për defekte që mund të jenë gjetur.

